



# Trajtimi i detajuar i shpenzimeve te buxhetit 1 (versioni i shkurter- pjesa 1)

(Resource ID: 401)

**Samantha Prior**

samantha.prior(at)ul.ie

This teaching resource is allocated to following University:

**UL - University of Limerick**

Institution:

**University of Limerick**

<http://www.sustainicum.at/sq/modules/view/401.Trajtimi-i-detajuar-i-shpenzimeve-te-buxhetit-1-versioni-i-shkurter-pjesa-1>



**Puna ne grup**



**Me pak sesa 5  
studente**



**Deri në 3 njësi  
leksionesh**



**Anglisht, Shqip**

Seti i mesimdhenies pershkruan tre burime te pavarura te mesimdhenies, te cilat jane te skicuara per t'u plotesuar njera pas tjetres dhe perfshijne: 1- Te mesuarin e bazuar ne problem- Buxheti ideal dhe nje debat 2- Nje problem, pikepamje te ndryshme- Buxhete ne vende te ndryshme 3- Intervista me palet kryesore te interesit dhe kerkimi ne nje zone kryesore ne buxhet Duke i pare ne detaje shpenzimet e buxhetit ( Versioni i shkurter- pjesa 1,2,3) bazohemi ne Burimin e Mesimdhenies " Inkurajimi i transparences i shpenzimeve publike, permes angazhimit te qytetareve". Burimi origjinal i mesimdhenies u nda per te lejuar lektoret te provojne teknika te reja te mesimdhenies dhe t'i paraqesin ato ngadale si pjese te setit te tyre te leksionit. Keto burime te mesimdhenies

synojne te trajtojne stilet e ndryshme te te mesuarit ne klase, dhe do te shpresojme te demonstrojne se te mesuarit aktiv eshte nje pjese vitale e cdo klase.

Pjesa 1- Te mesuarit me baze problemin- Buxheti ideal dhe nje debat

Studentet do te punojne ne grupe me 3 persona dhe do t'u jepen €5,000,000 dhe ata duhet te vendosin ku do te duan t'i shikojne ato para te shpenzohen dhe te shpegojne perse eshte bere ajo zgjedhje e zonave perkatese. Cdo grup do t'i prezantoje keto ide ne klase dhe do debatohet perse ata mendojne se keto zona jane me te rendesishme se te tjerat.

Teksti kryesor:

Shpenzimet publike dhe buxheti i shtetit jane shume te rendesishme dhe jane ne interes te publikut. Eshte e rendesishme t'u jepet akses qytetareve ne financat dhe fondet publike, ku treguesit jane lehtesisht te aksesueshem, te ndare dhe te perdorur ne nje menyre efektive. Duke kontrolluar shpenzimet, manipulimet dhe parregullsitet, mund te shmangjet mundesia e korrupsionit. Ky burim mesimdhenieje synon te angazhoje studentet ne procesin e shpenzimeve publike dhe i lejon ata te kuptojne parregullsitet dhe abuzimet qe ndodhin gjate procesit te shperndarjes se buxhetit.

Nje element i rendesishem i qeverise dhe per te cilin publiku eshte i shqetesuar eshte transparencja e shpenzimeve ne buxhetin e shtetit. Menyra me e mire per te promovuar besueshmerine eshte permes rritjes se transparences se financave publike, cilesise se informacionit te prodhuar dhe te shperndare, besueshmerise dhe pjesemarrjes nga komunitetet lokale dhe gjithashtu duke rritur presionin pozitiv ne zyrtaret e zgjedhur per te permiresuar sherbimet e ofruara tek qytetaret. Transparencja, sesi po harxhohen parate e taksapaguesve po behet ne grantet e qeverise, sherbimet administrative dhe investimet e infrastruktures eshte e dobet, Liria e Informacionit tek qytetaret dhe grupet e tjera te interesit si media, ende mbetet nje ceshtje e madhe per t'u adresuar me kujdes.

Ne kete menyre, studentet pyeten te ndermarrin nje udhetim ne terren ne zyrat e qeverisjes lokale per te analizuar nese ka parregullsi gjate shperndarjes se buxhetit. Studentet do te angazhohen ne vleresimin e te dhenave dhe ne kerkim, si dhe do te intervistojne zyrtaret kryesore. Ata do te kene mundesine te hetojne nje teme qe e zgjedhin vete ( per shembull, shpenzimet publike lokale, shpenzimet qendrore publike, tenderat,

perzgjedhja, kostot e udhetimeve, etj.) Tema se bashku me kerkimin do te bihet dakort ne bashkepunim me lektoret dhe do te prezantohen palet e interesit kryesore ndersa eshte zhvilluar nje vleresim i buxhetit.

---

## Mjetet e mesimdhënies



Loje□

## Integrimi i palëve të interesuara shoqërore

Keshilltaret financiare dhe zyrtaret e qeverise jane pjese e burimit te mesimdhënies si partnere aktive. Studentet kane mundesine te jene ne kontakt direkt me ata te punesuar qe jane te perfshire ne financat publike dhe te mesojne me shume per sfidat e hasura ne raportet e dhena per ceshtjet e buxhetit.

### Pika e forte

- Pervoja e te mesuarit aktiv per studentet
- Mesojne te punojne ne grupe
- Te kuptojne rendesine e shpenzimeve financiare
- Studentet mesojne te zhvillojne mjete per ndikimin e zyrtareve dhe te jene pjese e shoqerise civile
- Palet e interesit perfitojne nga perceptimet e te kuptuarit publik dhe pikepamja e tyre sesi te ndryshojne gjerat.
- Studentet mendojne per pergjegjesite e tyre ne kontekstin e puneve publike.

### Pika e dobët

- Ceshtjet me mungesen e bashkepunimit nga zyrtaret publike
- Mungesa e informacionit te publikuar per financat publike

## Rezultatet e të mësuarit

- Te vendosin ku do te shpenzohet buxheti prej 5 milione euro.
- Te debatojne me grupet e tjera per shpenzimet e zgjedhura

## Lidhja për qëndrueshmëri

- Te rritin ndergjegjesimin publik ndaj shpenzimeve publike
- Nje publik i informuar do te ushtroje presion te vazhdueshme tek zyrtaret e zgjedhur per te permiresuar sherbimet publike, qe eshte nje proces i vazhdueshem

## **Njohuri paraprake**

Asnje lloj njohurie paraprake specifike nuk kërkohet?

## **Përpjekjet e përgatitjes**

Te□ pakta

## **Përshkrimi i përpjekjeve të përgatitjes**

I paaplikueshem

## **Aksesi**

Free

## **Gjykimi / vlerësimi**

I paaplikueshem

## **Kreditim/Çertifikatë**

I paaplikueshem

## **Financuar nga**

This teaching resource, realised within the project ConSus, has been funded with the support of the TEMPUS of the European Union. The contents reflect the views of the authors, and the European Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.